

# ABC-SË (KONGRESIT TË MANASTIRIT)

## *HALO MALA*

Mellan<sup>1</sup> nuk na lanë për shkrimin  
(T'u shkruanim e kishim hak),  
Po ne prap' se prap' u shkruam,  
Penën e ngjyem në gjak!

Ndaj pushka na mbeti supit,  
Se plumbin e kishin pak,  
Që ajo të mos na ndryshkej,  
Mbanim një qinare<sup>2</sup> gjalpë.

I nderuam dritëtarët  
(Që u mblodhë' në Manastir):  
Mrojtëm gjuhën tonë te ëmbël,  
Shkrojtëm gjuhën tonë të dliirë!

***22 nëntor 2024***

---

<sup>1</sup> *mellan* – bojë shkrimi

<sup>2</sup> *qinare* – gotë llamarine e vogël me dorezë

Siç e dimë të gjithë, ne i përkasim një vendi të vogël europian, por që në gjithë historinë tonë, kemi luajtur rol të rëndësishëm në historinë europiane, poashtu dhe atë ballkanike. Figura të mëdha të kombit tonë janë bërë pjesë e historisë jo vetëm shqiptare, por dhe asaj ballkanike. Asnjëherë këto figura nuk kanë orjentuar kombin e tyre për pushtime apo invadime të kombeve apo popujve të tjerë, veç sa janë munduar të luftonin shumë gjatë në historinë e tyre, për t'u çliruar nga pushtuesit e vendit të tyre, siç ishte rasti i Perandorisë Osmane.

Këto pushtime kanë hapur dhe plagë të tjera sociale, përveç rrëmbimit të territoreve, si rasti i heqjes të së drejtës së gjuhës, që është një e drejtë egzistenciale për çdo komb.

Fundi i shekullit të 19-të e fillimi i shekullit të 20-të, Rilindasit tanë e shtuan veprimtarinë kombëtare në të gjitha drejtimet, e sidomos për çështjen e gjuhës shqipe, të cilën e konsideronin si vetë kombin shqiptar. Mirëpo, nga Perandoria Turke, që po nxirrte në dritë Xhonturqit, dhe ortodoksia greke, ky qëllim i Rilindasve tanë u pa me një armiqësi dhe egërsi të pashoq.

Rilindasit po përgatishnin aktin e pavarësisë së Shqipërisë, mirëpo ata shikonin si primare çështjen e alfabetit shqip, përpara pavarësisë. Për këtë arsye ata në mesin e nëntorit deri më 22 nëntor 1908 organizuan me figurat më të ndritura të intelektualizmit shqiptar, Kongresin e Manastirit, në të cilin u vendos dhe alfabeti i gjuhës tonë, duke lënë në njërën anë alfabetet e tjerë, që ishin përdorur deri atëherë.

Por lufta dhe terrori greko-osman mbi intelektualët shqiptarë ishte e paparë, e, megjithatë, ata ishin të vendosur që, jo vetëm të vendosnin alfabetin, por të hapnin edhe shkolla në gjuhën shqipe, ku do të përdorej alfabeti i Manastirit, alfabeti latin. Shumë figura u sakrifikuan, si Papa Kristo Negovani me vëllain e me katër aktivistë të tjerë që hapën shkolla shqip dhe mbanin mesha fetare në gjuhën shqipe.

Papa Kristoja deklaroi në një meshë në gjuhë shqipe: “Edhe perëndia flet gjithënjë në gjuhë shqipe” Që nga ajo ditë, bashkë me vëllain dhe katër aktivistët e tjerë do të persekutoheshin dhe do të ekzekutoheshin.

Intelektuali tjetër Pandeli Sotiri do të deklaronte: “Mua më vrisni, por gjakun tim ma ruani, që nipërit e mi të shkruajnë gjuhën shqipe!” Ekzekutimet dhe persekucionet mbi këto figura kanë qenë nga më makabret, më çnjerëzoret. Prandaj poeti shprehet: “*Mellan nuk na lanë për shkrimin, (T’u shkruanim e kishim hak)*”

Pra ju nuk na lejuat bojë për të shkruar shkronjat tona. Por sepse e kemi të drejtë të shkruajmë gjuhën tonë, e kemi hak, ne përdorën gjakun e martirëve tanë për bojë (siç na e lanë amanet) dhe shkronjat, gjuhën tonë, nuk e lamë pa shkruar: “*Penën e ngjyem në gjak!*”

Kongresi i Manastirit u mbajt me masa të rrepta sigurie, i ruajtur nga çetat e patriotëve Çerçiz Topullit e Demo Eminit, që u kishin shtirë tmerrin grekëve dhe administratës turke, në jugun e Shqipërisë.

Kjo ishte arsyeja që ne pushkën e kemi mbajtur gjithëmonë supit, sepse ata, armiqtë tanë, me torturat që kishin bërë mbi figurat tonë e kishin pak një plumb, pra donin diçka më shumë. Prandaj shprehet poeti në poezinë: “*Ndaj pushka na mbeti supit, Se plumbin e kishin pak*”

Eqë, kjo pushkë, të ishte e gatshme në çdo kohë, për të mbrojtur alfabetin tonë, nuk duhej lënë të ndryshkej e, në mungesë të vajit të pushkës, të përdorej gjalpë, nga kuzhinat e nënave tona: “*Që ajo të mos na ndryshkej, Mbanim një qinare gjalpë*”

Brezat pasardhës i nderuan dritëtarët e Manastirit sepse ata e ruajtën dhe e mësuan edhe me pushkë alfabetin shqip: “*Gjuhën tonë të ëmbël, gjuhën tonë të dliër*”.